

PERSONAT E ZHDUKUR



Ekspertët mjeko-ligjorë të EULEX-it punojnë me homologët vendas në Institutin e Mjekësisë Ligjore dhe institucionet tjera përkatëse për ta përcaktuar fatin e personave të zhdukur duke ofruar ekspertizë dhe këshilla, në mënyrë që anëtarët e familjeve ta realizojnë të drejtën e tyre për ta ditur të vërtetën.

Nga fillimi i mandatit të EULEX-it deri më 14 qershor 2025

EULEX-i ka marrë pjesë aktive në **873 operacione në terren** për gjetjen e personave të zhdukur, duke përfshirë **219 zhvarrime**. Mbetjet mortore të **543 personave** janë identifikuar, duke përfshirë **370 persona të zhdukur**.

EULEX-i vazhdon ta menaxhojë programin e tij për mbrojtjen e dëshmitarëve.



Misioni i ndihmon Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar me mbështetje logjistike dhe operacionale në përputhje me legjislacionin përkatës të Kosovës.

Fakte të shpejta

Shefi i Misionit:

Giovanni Pietro Barbano (Itali)

 Kohëzgjatja e mandatit aktual:
15 qershor 2025 – 14 qershor 2027

 ≈ 400 pjesëtarë vendas dhe ndërkombëtar

 Prishtinë, Kosovë

Baza ligjore:

- ☐ Vendimi i Këshillit (CFSP) 2025/1161
- ☐ Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i muajit shkurt 2008
- ☐ Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999)

EULEX-i mbështetet nga:



dhe



 eulex.kosovo

 eulexkosovo

 eulex.kosovo

 eulex-mission-in-kosovo

 EULEXKosovo

 eulexkosovo.bsky.social

 www.eulex-kosovo.eu

 press@eulex-kosovo.eu
info@eulex-kosovo.eu

**Misioni i Bashkimit Evropian
për Sundimin e Ligjit
në Kosovë**

Partneriteti për Drejtësi





KUSH JEMI NE

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX Kosovo) ka filluar punën në vitin 2008 si misioni civil më i madh në kuadër të Politikës së Përbashkët të Bashkimit Evropian për Siguri dhe Mbrojtje. Misioni i tij është që t'i mbështesë institucionet e përgjegjdhura të Kosovës për sundimin e ligjit në rrugën e tyre drejt rritjes së efektivitetit, qëndrueshmërisë, shumë-etnicitetit dhe llogaridhënies, të lira prej ndërhyrjeve politike dhe në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe praktikatat më të mira evropiane.

ÇFARË BËJMË NE

EULEX-i e vlerëson respektimin e sundimit të ligjit dhe detyrimeve për të drejtat e njeriut nga institucionet e përgjegjdhura të Kosovës, me një përkushtim të qartë kundër çdo forme të shkeljes së të drejtave të njeriut apo të diskriminimit.

EULEX-i e zbaton mandatin e tij përmes Shtyllës për Monitorim dhe Shtyllës për Mbështetje të Operacioneve. Misioni është i përkushtuar për përfshirjen e të drejtave të njeriut dhe standardeve të integritetit gjinor në të gjitha aktivitetet e tij.



SHTYLLA E MONITORIMIT



EULEX-i e vlerëson funksionimin e gjyqësorit të Kosovës në aspektin e përputhshmërisë procedurale, ligjore dhe të drejtave të njeriut përmes monitorimit të rasteve të përgjegjdhura në të gjithë zinxhirin e sistemit të drejtësisë penale, pra në nivelin policor, prokurorial dhe gjyqësor. Nga muaji qershor 2018 deri më 14 qershor 2025, monitoruesit e EULEX-it për drejtësi morën pjesë në:

2,840 seanca gjyqësore në **395** çështje aktive penale dhe civile

që përfshijnë raste të profil të lartë, raste të krimeve të luftës, raste të dhunës në baza gjinore, raste të korrupsionit dhe raste që janë trajtuar nga EULEX-i në të kaluarën. Ky monitorim rezultoi në raporte me gjetje dhe rekomandime për autoritetet e Kosovës me qëllim të përmirësimit të sistemit të drejtësisë.

Me anë të monitorimit, mentorimit, dhe këshillimit, Njësia Korrektuese EULEX-it e mbështetë Shërbimin Korrektues të Kosovës (SHKK) për konsolidimin e një ekipi menaxhues profesional dhe për ngritjen e kapaciteteve të ofrimit të rehabilitimit dhe luftimit të ndërhyrjeve dhe të trajtimit preferencial të burgosurve. EULEX-i gjithashtu i asiston Shërbimit Sprovues të Kosovës (SHSK) për zhvillimin e një qasjeje të strukturuar për rehabilitimin e të dënuarve me kusht me fokus në parandalimin e përsëritjes së veprave.

Nga muaji qershor 2018 deri më 14 qershor 2025
Stafi i Njesisë Korrektuese të EULEX-it:

- Kanë kryer mbi 1150 vizita në teren në institucione korrektuese të ndryshme dhe në zyra rajonale të sprovimit si dhe kanë mbajtur me qindra takime me stafin e SHKK-së dhe SHSK-së në mbështetje të menaxhmentit për adresimin e çështjeve strategjike.
- Kanë monitoruar 109 përcjellje në spitale të burgosurve të profil të lartë.
- Kanë mbështetur sesione trajnuese, punëtori dhe grupe punuese për mbi 2600 pjesëmarrës.

SHTYLLA PËR MBËSHTETJE TË OPERACIONEVE



EULEX-i është reaguesi i dytë i sigurisë në Kosovë, si pjesë e një mekanizmi të reaguesve të sigurisë me tre nivele. Njësia Policore e Specializuar (NJPS) e EULEX-it mund të angazhohet vetëm me kërkesë specifike të reaguesit të parë të sigurisë në mënyrë që të kontribuojë në ruajtjen dhe promovimin e rendit publik dhe sigurisë në rastet e trazirave qytetare.

NJPS kryen patrullime mobile vëzhgimi për t'u informuar mbi situatën dhe në vazhdimësi angazhohet në ushtrime të përbashkëta me Policinë e Kosovës dhe KFOR-in për kontrollimin e turmave dhe trazirave.

BASHKËPUNIMI POLICOR NDËRKOMBËTAR

EULEX-i e lehtëson shkëmbimin e informatave policore ndërmjet Policisë së Kosovës dhe Interpolit, Europolit apo Ministrisë së Brendshme të Serbisë.

Kërkesat e pranuar dhe të dërguara nga EULEX-i nga muaji qershor 2018 deri më 14 qershor 2025

	↔		↔	
14,645				
(përmes Zyrës Ndërlidhëse të Interpolit në kuadër të UNMIK-ut)				
	↔		↔	
1,871				
	↔		↔	
3,653				
MPB e Serbisë				